

Kontrolli i Lartë i Shtetit merr pjesë në workshop-in “Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit”

Në datë 04.12.2023, në ambientet e “Grand Hotel Tirana” u zhvillua workshop-i me temë “Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit”. Fokusi i workshop-it ishte kontributi që shoqëria civile dhe komuniteti i biznesit mund të japi në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e tij. Panelistët kryesorë ishin z. Zef Preci, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të ACER dhe z. Gjergj Buxhuku, si Administrator i Përgjithshëm i Konfindustria, të cilët i përqëndruan prezantimet e tyre posaçërisht nga këndvështrimi i shoqërisë civile dhe biznesit lidhur me problematikat që përballen këto dy komunitete në kuadër të korrupsionit.



Konkluzioni i përbashkët ishte nevoja për bashkim të dy komuniteteve brenda tyre dhe me njëri-tjetrin për të potencuar parandalimin e korrupsionit. Pjesa teknike e prezantuar nga ekspertët konsistoi në paraqitjen e të dhënave lidhur me “Sistemin e Monitorimit të Korrupsionit” implementuar nga projekti SELDI. Ky sistem ishte funksional prej vitit 2001 dhe përditësohej çdo dy vite, duke krahasuar progresin apo regresin e nivelit të korrupsionit në fusha të caktuara. Në Shqipëri, ky sistem konsistonte në një anketim me një kampion prej 1015 qytetarësh me indikatorë në bazë përvoja, sjelljeje dhe perceptimi. Sipas ACER, qasja dhe reagimi ndaj korrupsionit është përmirësuar dy vitet e fundit me presion të perceptuar dhe pranueshmëri të korrupsionit 5% më pak se në 2021. KLSH në këtë aktivitet u përfaqësua nga audituesja e Departamentit të Institucioneve Qendrore znj. Lorena Lici.